



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:132151

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06001790

CAP.nr.507/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, me gjyqtarin individual Adnan Konushevci, në çështjen përmbartimore të kreditorit XH.SH nga P..., Rr. "Muharrem Fejza", C.15/12, nr.5, kundër debitorit Kolegji Iliria me seli në Prishtinë, Rr. "Gazmend Zajmi", nr.75, me bazë juridike përmbartimore-pagesë e të ardhurave, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr.354/2021 të datës 23.02.2023, jashtë seance me datë 30.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e debitorit Kolegji Iliria me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr.354/2021 i datës 23.02.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar CPC.nr.354/2021 të datës 23.02.2023, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Kolegji Iliria me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër aktvendimin Cpc.nr.354/21 të dt.17.06.2022, mbi caktimin e përmbartimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar prapësim debitori të cilin gjykata e shkallës së dytë e ka trajtuar si ankesë, duke mos cekur shkaqet ankimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj ankesën dhe të prish aktvendimin e atakuar dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarrues – Vendimit të Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës në Prishtinë 01 Nr.33-479/2020 të datës 27.11.2020, i cili është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 15.12.2020, lidhur me pagesën e të ardhurave personale në shumën e prej 12,000.00 euro, duke kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbarrim të kreditorit me aktvendimin Cpc.nr.354/2021 të datës 17.06.2022, ka lejuar përmbarrimin. Kundër aktvendimit për përmbarrim pala debitore brenda afatit ligjor nëpërmjet postës me datën 14.07.2022, ka paraqitur prapësim, Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe prapësimi, me aktvendimin e atakuar ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelle thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim dhe ankesë i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbarrimor, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për faktin se nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbarrimor i plotëson kushtet ligjore për përmbarrim, konform dispozitave ligjore në fuqi, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarrimor të papërshtatshëm për përmbarrim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbarrimor-Vendimi administrativ i Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, 01 Nr.33-479/2020 të datës 27.11.2020, i njëjti në dispozitiv e përmban shumën e detyrimit, e që dihet saktë se si do të ekzekutohet. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit

gjen se nuk qëndrojnë pretendimet në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbartueshmërisë së dokumentit përmbartimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, andaj për Gjykatën e Apelit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar si të bazuar prapësimin e debitorit.

Pretendimi ankimor i debitorit se vendimi administrativ është i pavlefshëm sepse është nxjerrë nga organi jokompetent dhe nuk paraqet titull ekzekutiv, Gjykata e Apelit vlerëson se është pretendim i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm, për faktin se gjykata në procedurën përmbartimore nuk ka tagër të lëshohet në ligjshmërinë e dokument përmbartues, ndërsa këto pretendime debitori ka mundur që ti zhvilloj në ndonjë procedurë tjetër, siç është në rastin konkret konflikti administrativ. Në procedurën përmbartimore organi përmbartues apo gjykata e cakton dhe zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues siç është aktvendimi 01 Nr.33-479/2020 të datës 27.11.2020, i cili i plotëson kushtet sipas dispozitave ligjore të LPP-së, për të qenë dokument i përmbartues.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.507/23 me datë 30.07.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci